



Pranuar / Dorezuar Prilijeno / Prodato Received / Delivery	16	11	2021	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
RAMSHCK	5465/2021		119	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.835/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca anëtarë, si dhe Sabile Avdyli -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.835/2021 të datës 29.09.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi fshati “Koshare” në Komunën e Ferizajit, kundër Vendimit KA.nr.46/2021 të datës 03.09.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 16.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I.** Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.835/2021 e datës 29.09.2021 e parashtruar nga ankuesja
- II.** Mbetet në fuqi Vendimi KA.nr.63/2021 i datës 03.09.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 27.05.2021 i protokolluar me datën 29.05.2021 me nr.03-1005 ka nxjerr vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës nga data 17.06.2021 për ankuesen e punësuar në pozitën Referente në Gjykatën Themelore në Ferizaj, duke ja njohur të drejtën e një page të njëhershme në vlerën e pagës së fundit, dhe pagesën e 150 Euro për muajin prill, maj dhe qershor 2021 janar dhe shkurt sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 18/60 të datës 07.08.2018. Në bazë të listës së pagave ankueses kompensimi sipas vendimi të lartcekur i është bërë në korrik të vitit 2021 në vlerën bruto 585.58 Euro ndërsa në vlerën Neto 549.22 Euro.

Ankuesja më datë 28.07.2021 ka parashtruar kërkesë tek Drejtori i Administratës së Përgjithshme dhe Personelit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për kompensimin e dy pagave mujore në vlerën e pagës së fundit dhe tri pagave jubilarë sipas kontratës kolektive. Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 05.08.2021 ka nxjerr Vendim DS-384/2021 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses me arsyetimin se parashtruesja e kërkesës ka realizuar pagesën në shumën prej një(1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit si dhe në vitin 2012 ka realizuar një pagë jubilarë me rastin e 10 vjetorit në shërbimin civil në shumën prej 82.50 Euro.

Ankuesja kundër këtij vendimi, më datë 01.09.2021 ka parashtruar ankesë me nr.09/1435 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 03.09.2021 ka nxjerr Vendim KA.nr.46/2021 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses.

Ankuesja kundër Vendimit KA.nr.46/2021 të datës 03.09.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes postës më datë 27.09.2021 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është pranuar më datë 29.09.2021 me Nr. Prot:4810/2021, me pretendimet ankimore për kompensimin e dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 04.10.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Më datë 21.10.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/11.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 29.09.2021 me numër protokollit 4810/2021 të datës 29.09.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KA.nr.46/2021 e datës 03.09.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimi i datës 27.05.2021 me numër ref.DS-275/2021 për përfundimin e marrëdhënies së punës; Vendimi i datës 05.08.2021 me numër ref.DS-384/2021 i nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit i datës 21.10.2021 bashkë me shkresat e lëndës; Fletëkthesa e datës 09.09.2021; Ankesa e datës 01.09.2021 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Listën e Pagave e datës 31.07.2021 dhe Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 21.10.2021 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/11.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses, **është e pabazuar, sepse:**

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës gabimisht është vlerësuar gjendja faktike sepse me Kontratën e Përgjithshme Kolektive me rastin e pensionimit, nëpunësit i takon kompensimi i dy pagave përcjellëse dhe tri pagave jubilarë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 sipas nenit 82 të saj, ndërsa ka pasur një kohëzgjatje prej tri vitesh siç parashihet me dispozitat e nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcaktohet që: **“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”**, mirëpo neni 81 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, respektivisht paragrafi 1 ka përcaktuar që: **“Nga MPKK, Palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese. Tërheqja nga kjo MPKK, shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës”**, bazuar në këtë Oda Ekonomike e Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshje më datë 15.09.2017 ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Neni 82 paragrafi 2 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës përcakton se: **“Nëse nga MPKK, pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga Palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit”**, mirëpo meqenëse njëri nga nënshkruesit e kësaj marrëveshje është tërheq nga zbatimi i saj tre muaj para skadimit e njëjta nuk vlen nga data e tërheqjes.

Meqenëse konstatohet se nga data 15.09.2017 Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është e zbatueshme, rrjedhimisht nuk mund të prodhohë asnjë pasojë juridike sepse më nuk është nënshkruar nga institucionet kompetente. Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka konstatuar se marrëdhënia e punës së ankuesit me rastin e pensionimit sipas vendimit të datës 27.05.2021 i ka përfunduar më datë 17.06.2021, atëherë kompensimi i tri pagave me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë sipas Marrëveshjes Kolektive të Kosovës nuk mund të bëhet.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse konstaton që Marrëveshja Kolektive e Kosovës nuk është në fuqi, atëherë kompensimin me rastin e pensionimit të nëpunësve civil bëhet në pajtim me dispozitat e nenit 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitat e nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë i cili përcakton se: **“Paragrafi 1. Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit”. Paragrafi 2. Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit”**, kështu që Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit DS-275/2021 të datës 27.05.2021 dhe Vendimit DS-384/2021 të datës 05.08.2021, me të cilin ankueses i është njohur e drejta e kompensimit të një page përcjellëse me rastin e pensionimit respektivisht i është refuzuar kërkesa për kompensimin edhe të dy pagave përcjellëse dhe tri pagave jubilarë, ka vepruar në pajtim dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë, kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.



Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se Vendimi KA.nr.46/2021 i datës 03.09.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është nxjerr në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë, kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.835/2021; datë 16.11.2021

Sabile AVDYLI


Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.

